

KËRKESË
Nr. 939/1, datë 26.6.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM
ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“MARIO FISHTA”

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“MARIO FISHTA”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000185-5

Datë 4.4.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000185-2, datë 18.3.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin Mario Fishta, me NIPT L71913011M, përfaqësues i autorizuar i subjektit Mario Fishta, prej datës 18.3.2019, ora 08:30 deri më datën 18.3.2019, ora 16:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datë 18.3.2019 dhe e njoftoi më datën 18.3.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, neni 29, pika 1/a/ii,

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, neni 29, pika 1/a/ii, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

- Gjobë 500 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

- Të pezullohet aktiviteti deri në pajisjen me lejen përkatëse mjedisore “C’montim i mbetjeve nga motorët e makinave”.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Jetnor Zhelegu ID: 0301020017

Ardi Pjetri ID: 0301020029

Kundër vendimit përfundimtar, subjekti Mario Fishta ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.